



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT
TIRANË

Nr. Regj. Them. 12893//10046/5506/1405 (31103-06908-86-2015) Nr. vendimi 4628 (86-2018-5238)
Data e Regjistrimit 16.11.2015 Data e vendimit 18.12.2018

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit, e formuar si trup gjykues, në përputhje me parashikimet e nenit 12, pika 2, shkronja “a”, të ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (ligji Nr. 49/2012), nga gjyqtarët:

Amarildo	LAÇI	KRYESUES
Alkelina	GAZIDEDJA	ANËTARE
Bari	SHYTI	ANËTAR

Asistuar nga sekretarja gjyqësore, [REDAKTUAR] në Tiranë, sot në datë 18.12.2018, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen me Nr. 12893//10046/5506/1405 (31103-06908-86-2015) akti, datë 16.11.2015, që iu përket:

PADITËS: Universiteti Politeknik i Tiranës.

TË PADITUR:

- 1.-Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Tiranë.
2. [REDAKTUAR] e bija e [REDAKTUAR] me adresë: Universiteti i Shkodrës [REDAKTUAR], sheshi [REDAKTUAR], Rruga [REDAKTUAR] Shkodër.

OBJEKTI:

- Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit Nr. 6, datë 20.01.2015, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit Nr. 103, datë 17.06.2015, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar efektet e akteve administrative, Vendimit Nr. 6, datë 20.01.2005; Vendimit Nr. 103, datë 17.06.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, deri në përfundim të këtij gjykimi.

BAZA LIGJORE: Nenet 32, 153, 154 e vijues të Kodit të Procedurës Civile; Ligji Nr. 49/2012 “Për organizimin, funksionimin e Gjykatës Administrative, dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve

administrative”; Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Ligji Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë ne Republikën e Shqipërisë”; Nenet 115 dhe 116 të Kodit të Procedurës Administrative.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me vendimin Nr. 4453 (80-2015-2747), datë 15.09.2015 ka vendosur:

- Rrëzimin e kërkesë-padisë.
- Shpenzimet gjyqësore mbetën siç janë bërë.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga dita e nesërme e marrjes dijeni për këtë vendim.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim me datë 15.10.2015, pala paditëse Universiteti Politeknik i Tiranës , duke parashtruar këto shkaqe, për ndryshimin e vendimit Nr. 4453 (80-2015-2747), datë 15.09.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, dhe pranimin e padisë:

- E paditura, [REDAKTUAR], i është drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me pretendimin së ajo është diskriminuar, për shkak të gjendjes arsimore.
- Me ankesën Nr. 94, datë 20.10.2014 e paditura i është drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke u pretenduar nga kjo e fundit, se, paditësi Universiteti Politeknik i Tiranës, për shkaqe që lidhën me gjendjen e saj arsimore ka diskriminuar këtë të fundit, duke e skualifikuar nga konkurrimi për të qënë pjesë e personelit Akademik të UPT -së.
- Në lidhje me moskualifikimin e Znj. [REDAKTUAR], për vetë specifikat që ka UPT-ja dhe departamenti i inxhinierisë fizike, kërkohet një formim bazë fizik i plotë dhe i thellë, i cili arrihet vetëm në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, të Universitetit të Tiranës apo në UPT. Vetëm ky kontingjent të diplomuarish janë me titullin “Fizikan” ose “Kërkues Shkencor”, të aftë për t’u angazhuar në mësimdhënie e kërkim shkencor në Institucionet e Arsimin të Lartë, sikundër është UPT. Ky ka qënë kriteri që nuk ka përmbushur znj [REDAKTUAR]
- Sa më lart, në rastin konkret nuk jemi në asnjë nga rastet e ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, dhe çdo pretendim për ekzistencën e diskriminimit të drejtpërdrejtë të znj. [REDAKTUAR] për shkak të gjendjes Arsimore, nga ana e paditësit, Universitetit Politeknik të Tiranës, është plotësisht i pabazuar dhe perceptim i gabuar që i padituri i ka bërë rrethanës së faktit civil.
- Në rastin konkret pretendohet se nuk jemi në kushtet e diskriminimit, për faktin se, e paditura ka kryer studimet në Universitetin Luigj Gurakuqi të Shkodrës, por mos kualifikimi i saj është bërë si rrjedhojë e mosplotësimin të disa kriterëve, të cilat janë thelbësore për pozicionin e punës që afrohet, dhe që e paditura nuk i zotëron.
- Pretendohet se, do të kishim qënë përpara rastit të diskriminimit të drejtpërdrejtë në rast, se e paditura do të ishte skualifikuar vetëm për shkakun se kishte përfunduar studimet në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, ndërkohe që ajo plotësonte të gjitha kriteret e kërkua.
- Pra ndryshe nga sa ka arsyetuar Gjykata e Shkalles së Pare, edhe pse akti ka dalë nga një organ administrativ që ka kompetencë që të shqyrtojë ankimet në lidhje me diskriminimin, çka në dukej e bën atë një akt të vlefshëm, jemi në kushtet kur ky

- organ duke kaluar kufijtë e ligjshmërisë, ka kaluar kompetencat e njohura me ligj. Kjo bën të mundur vendosjen në kushtet e nenit 116/b të K.Pr.Administrative.
- Është e qartë se qëllimi i ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” është të garantojë, barazi përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin.
 - Në rastin konkret vendimi Nr. 6, datë 20.01.2015 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bie haptazi ndesh me frymën dhe qëllimin e ligjit “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, për shkak se, cenon pavarësinë e paditësit, Universitetit Politeknik Tirane, për të përcaktuar kriteret përzgjedhëse të stafit të vetë akademik, por njëkohësisht vetë komisioneri, me vendimin e saj ka krijuar një klimë diskriminuese, duke cenuar nenin 2, pika b) të ligjit Nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”, (barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat). Sqarohet se detyrimi për garantimin e barazisë të shanseve dhe mundësive nuk nënkupton heqjen e çdo kriteri përzgjedhës, por nënkupton që kriteret në thelb të mos kenë karakter diskriminues. Ndërkohë që anashkalimi, heqja, apo shmangia e kriterëve kur ato nuk janë diskriminuese, dëmton thelbin e konceptit të barazisë dhe shanseve dhe mundësive”, që ligji synon të garantojë.
 - Në rastin konkret, kriteri minimalisht është kërkuar të kenë “Diplomë të integruar 5 vjeçare në fizikë (300 kreditë) ose “Bachelor” 3 vjet + 2 vjet “Master Shkencor” në Fizikë apo Fizikes së Aplikuar, apo mungesa e 8 lëndë/module të Fizikës së avancuar të cilat janë themelore, për formimin bazë të kërkuesit shkencor në përputhje me profilin që ka DIF, nuk janë dhe nuk mund të konsiderohen si kriterë diskriminuese.
 - Pala e paditur duke konsideruar të panevojshme dhe duke kërkuar heqjen e kriterëve të përcaktuara nga Departamenti i Inxhinierisë së Fizikes, ka vepruar në tejkalim të kompetencave të saj, dhe në kundërshtim me frymën e ligjit, duke cenuar nenet 116 dhe 115 të K.Pr.Administrative.
 - Jemi përpara të dy rasteve të pavlefshmërisë absolute të Vendimit Nr. 6, datë 20.01.2015 të Komisionerit, të parashikuara në nenin 115/a dhe 116/b të K.Pr.Administrative, pasi ky akt, përveç se bie në kundërshtim me vetë qëllimin e ligjit Nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përveç se provokon një situatë diskriminuese, duke kërkuar mos aplikimin e kriterëve të cilat shërbejnë pikërisht, për të garantuar barazi në shanse dhe të drejta të subjekteve që i kane këto kriterë, për me tepër në tejkalim të kompetencave duke kërkuar shfuqizimin/heqjen e kriterëve të caktuara nga DIF-së, dhe duke cenuar ligjin “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” .
 - Së dyti, në rast se znj. ██████ kishte pretendim lidhur me kriteret e punësimit, ajo kishte në dispozicion të gjithë kohën e nevojshme për të kundërshtuar kriteret e shpallura, gjë të cilën nuk e bëri. Fakti që ajo pranoi të hyjë në konkurrim mbi bazën e këtyre kriterëve tregon se ajo nuk kishte asnjë kundërshtim lidhur me to. Vetëm pasi nuk u shpall fituese në konkurrim, Znj. ██████ shprehu kundërshtimin e saj lidhur me kriteret e përcaktuara, gjë që e bën ankesën e saj jo vetëm të pabazuar, por edhe abuzive, ndërkohe që të gjitha kriteret janë përcaktuar në përputhje me programin mësimor dhe kurrikulat e palës paditëse.
 - Së treti, pretendimi se Znj. ██████ nuk është shpallur fituese, jo vetëm se nuk ka fituar titullin “Fizikante”, por edhe sepse nuk është diplomuar as pranë UPT-

së dhe as pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës të UT-së, është i pabazuar. Kjo, pasi në asnjë rast nuk është paragjykuar Diploma e studimit apo cilësia e saj, por niveli i studimit dhe fusha që ajo mbulon. Komisioni ad hoc bëri një vlerësimin objektiv mbi bazën e kriterëve kualifikuese të shpallura.

- Në vendimin e palës së paditur, objekt ankimi, kjo e fundit është shprehur se pavarësisht titullit “mësuese fizike” që ankuesja ka fituar në bazë të diplomës së studimeve të larta, ajo ka kryer studime pasuniversitare të nivelit Master në Fizikë, Doktoraturë në Fizikë dhe ka fituar titullin akademik “Profesor i Asociuar”, sikurse një i diplomuar pranë UPT dhe FNSH që gëzon titullin “Fizikan”. Me anë të këtij gjykimi i padituri nënkuptoni që ankuesja ka plotësuar kriteret për t’u punësuar pranë Institucionit paditës. Lidhur me sa më sipër, pretendohet se edhe ky përben një cenim të nenit 116/b të K.Pr.Administrative, dhe për rrjedhojë shkak për pavlefshmërisë absolute të aktit, për aq sa ky është një shkak ligjore që ka të bëjë me vendimmarrjen e komisionit, gjë e cila nuk është në kompetencë të Komisionerit.
- Në zbatim të Vendimit Nr. 6, datë 20.01.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ky i fundit ka nxjerre Vendimin Nr. 103, datë 17.06.2015, me të cilin ka disponuar si me poshtë: *“Rektori i Universitetit Politeknik të Tiranës të gjobitet në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë. ... Rektori i Universitetit Politeknik të Tiranës duhet të njoftojë Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në përputhje me sa parashikohet në pikën 3 të këtij vendimi.*
- Duke qenë se Vendimi Nr. 103, datë 17.06.2015 i Komisionerit ka dalë në zbatim të Vendimit Nr. 6, datë 20.01.2015, i cili është absolutisht i pavlefshëm, kërkohet nga gjykata pavlefshmëria absolute edhe për këtë vendim. Në bazë të nenit 28 dhe 29 të ligjit Nr. 49/2012, është kërkuar marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke bërë pezullimin e efekteve të akteve administrative, vlefshmëria e të cilëve goditet në këtë proces gjyqësor.
- Në bindjen e paditësit ekzistojnë të dy kriteret lejuese të parashikuara në nenin 29 të ligjit 49/2012, pasi ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në shkresa në mundësinë e shkaktimit të një demi të rëndë të pakthyeshem si rrjedhojë e aplikimit të vendimit Nr. 6, datë 21.01.2015, dem i cili konsiston në detyrimin e palës paditëse që të reduktoje kriteret përzgjedhëse në praktikën e saj, çka do të thotë në mundësinë potenciale të njerëzve të cilët nuk kanë kapacitetet profesionale, për të përmbushur detyrat e tyre. Pretendohet se paditësi është në kushtet, kur si rrjedhojë e aplikimit të efekteve të aktit, nuk jemi përpara cenimit të ndonjë interesi publik.
- Në këto rrethana, në kushtet kur palës paditëse mund t’i vije një dem i rende, i pakthyeshem, i atëçastshëm, si rrjedhojë e rekrutimit të subjekteve të cilët nuk plotësojnë kriteret e nevojshme për këtë pozicion, dhe për rrjedhojë do të jetë i detyruar që ti ekspozohet një marrëdhënie punësimi, për një afat të pacaktuar, pa përmendur efektet që do të këtë tek studentet të cilët do të drejtohen nga një Pedagog që nuk ka kapacitet e kërkuara për të dhënë këtë lende, atëherë padyshim jemi në kushtet e një demi të rende, dhe të parikuperueshem.
- Përsa më sipër, në kushtet kur, kriteri i punësimit lidhur me diplomën universitare është një kriter objektiv, i domosdoshëm dhe i lidhur me pozicionin e punës, nuk është aspak diskriminues. Në kushtet kur Znj. [REDAKTUAR] nuk ka shprehur asnjë objeksion lidhur me këtë kriter punësimi, por ka pranuar të konkurrojë mbi bazën e tij, si dhe në kushtet kur vlerësimi i Komisionit ad hoc ka qenë objektiv dhe i bazuar

mbi kriteret kualifikuese.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, në respektim të kërkesave ligjore të neneve 46 dhe 48 të ligjit Nr. 49/2012, ka vendosur: Pranimin e ankimit të palës paditëse, Universiteti Politeknik i Tiranës.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT.

Në dhomë këshillimi, si verifikoi se ankimi plotësonte kushtet e pranueshmërisë, në vështrim të nenit 46(2) të ligjit Nr. 49/2012;

konstatoi se palët ndërgjyqëse kishin dijeni rregullisht për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të shqyrtimit të çështjes, në konformitet me përcaktimet e nenit 49(2), fjalia e dytë, të ligjit Nr. 49/2012, në lidhje me nenin 482(2) të K.Pr.Civile;

pasi u njoh me *relacionin e përgatitur nga gjyqtari Amarildo Laçi*, dhe e shqyrtoi çështjen, brenda shkaqeve të ngritura në ankim, në përputhje me normat ligjore relevante materiale e procedurale,

V Ë R E N:

Vendimi Nr. 4453 (80-2015-2747), datë 15.09.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, është rrjedhojë e zbatimit korrekt të ligjit dhe analizës së saktë e koherente të provave të marra në shqyrtimin gjyqësor, ndaj ai duhet të lihet në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit, në përputhje me germën “b”, të nenit 50 të ligjit Nr. 49/2012.

I. Rrethanat e çështjes:

Pala e paditur, [REDAKTUAR], me detyrën pedagoge e jashtme, pranë Fakultetit të Inxhinierisë, Matematikës dhe Inxhinierisë Fizike të Universitetit Politeknik Tiranë, ka shfaqur interes për dy pozicione të lira, për personel akademik pranë Universitetit Politeknik Tiranë (më poshtë: “UPT”). Në lidhje me këtë pozicion nga ana e saj është depozituar kërkesa e aplikimit në datën 16.09.2014 së bashku me dokumentacionin përkatës, pranë Degës së Burimeve Njerëzore të Rektoratit.

UPT-ja ka shpallur konkurs për dy pozicione të lira të personelit akademik, pranë Departamentit të Inxhinierisë, Matematike & Inxhinierisë Fizike. E paditura ka depozituar kërkesën dhe dokumentacionin e kërkuar në datën 16.09.2014, në Degën e Burimeve Njerëzore të Rektoratit, për të konkurruar për një nga pozicionet, por në datën 17.09.2014 ka rënë në dijeni të faktit se është skualifikuar pasi nuk plotëson të gjitha kriteret e nevojshme. Në përgjigjen që i është dhënë paditëses i është shpjeguar kriteri që është bere shkak për skualifikimin e saj, i cili është “Kandidati për këtë vend pune duhet të këtë: “Diplomë, Master i Shkencave” ne sistemin 3+2, Diplomë e Nivelit të Dytë, Diplomë të integruar të nivelit të dytë, (sistemi 5 vjeçar), në Inxhinieri Fizike, FIMIF në UPT dhe Fizikë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, UT, ose në degën ekuivalente me to, jashtë vendit”, ndërkohë që e paditura ka përfunduar studimet në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, në Shkodër.

Në datën 17.09.2014, pala e paditur është informuar se faza e dytë e vlerësimit është zhvilluar, dhe se znj. [REDAKTUAR] është skualifikuar se nuk plotësonte të gjitha kriteret. E paditura

██████████ i është drejtuar me Ankesën Nr. 94, datë 20.10.2014 Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (më poshtë: "KMD"), duke pretenduar diskriminim, për shkak të gjendjes arsimore, nga ana e Universitetit Politeknik të Tiranës.

Me vendimin Nr. 6, datë 20/01/2015, KMD-ja, në bazë të neneve 3, 4, 5, pika 1, 7, pika 1, nenet 12, 13, 15, 21 pika 1, 3, 2, gërma c), si dhe nenit 33, pikat 1, 3, 5, 7 dhe 12, të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", ka vendosur:

1. Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë të Znj. ██████████ për shkak të gjendjes arsimore, nga ana e Rektorit të Universitetit Politeknik të Tiranës.

2. Konstatimin e diskriminimit të tërthortë të kandidatëve që janë diplomuar pranë Universiteteve të Rretheve, në Fakultetin e Fizikës dhe zotërojnë një diplomë të nivelit të dytë të integruar, për shkak të gjendjes arsimore, nga ana e Rektorit të Universitetit Politeknik të Tiranës.

3. Rekomandojmë marrjen e masave të nevojshme, nga Rektorati dhe Dekanati i Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Fizike, për ndryshimin e kriterit përjashtues në të gjithë njoftimet për punësim për personel akademik, nga data e daljes së këtij vendimi

4. Rekomandojmë marrjen e masave të nevojshme nga Rektorati dhe Dekanati i Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Fizike, për njohjen e të gjithë punonjësve të këtij institucioni me ligjin Nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", si dhe një kopje e këtij ligji të afishohet në ambientet e brendshme të institucionit."

Në vendimin e saj pala e paditur, ka arsyetuar se:

"Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankuesja, konstatohet se:

Në periudhën 1994-1998 ka kryer studimet e larta në Degën e Fizikës, pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore në Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër. Referuar diplomës së saj, rezulton se titulli i fituar nga ankuesja është "mësuese e fizikës".

Në periudhën 2003-2007, ankuesja ka kryer Mastë në Fizikë, me drejtim Biofizikë, pranë Departamentit të Fizikës, të Fakultetit të Shkencave Natyrore, Tiranë.

Në periudhën 2005-2009 ka kryer studimet e Doktoraturës në Departamentin e Fizikës, pranë Universitetit të Bolonjës, nga ku ka fituar titullin "Doktor" në Fizikë. Nëpërmjet Vendimit Nr. 154, datë 08.10.2010, të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, grada e fituar në Itali nga Znj. ██████████ është e barazvlefshme me gradën "Doktor" në Republikën e Shqipërisë.

Në vitin 2014, mbështetur në Vendimin m. 63, datë 18.12.2013, të Këshillit të Profesorëve të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, së Universitetit të Tiranës, Znj. Entelë Gavoçi, referuar Dëshmisë Nr. 40, datë 27.05.2014, të lëshuar nga Universiteti i Tiranës, ka fituar titullin "Profesor i Asociuar".

Për sa më sipër, gjykojmë se pavarësisht titullit "mësuese fizike" që ankuesja ka fituar në bazë të diplomës së studimeve të larta, i cili është konsideruar si kriter skualifikues për të për t'u punësuar dhe për të qenë pjesë e stafit akademik të Departamentit të Inxhinierisë Fizike, të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike & Inxhinierisë Fizike, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, në vijim ajo ka kryer studime pasuniversitare të nivelit Master në Fizikë, Doktoraturë në Fizikë dhe duke fituar së fundmi titullin "Profesor i Asociuar", sikurse një i diplomuar pranë Universitetit Politeknik të Tiranës apo Fakultetit të Shkencave Sociale, në Tiranë, që gëzon titullin "fizikan".

Duke iu përmbajtur kriterit përcaktuar në pikën 1, të njoftimit të datës 08.09.2014, rezulton se në bazë të tij, përjashtohen nga konkurimi në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe të gjithë kandidatët që zotërojnë një diplomë të integruar të nivelit të dytë në degën e Fizikës, në

Universitetet e rretheve. Pra, duke iu referuar sërish njoftimit të mësipërm, gjykojmë se kriteri përjashtues për Znj. [REDAKTUAR], nuk ka qenë vetëm fakti se ajo nuk zotëronte një diplomë të nivelit të dytë (5- vjeçar) apo një diplomë të integruar të nivelit të dytë (5-vjeçar), në bazë të së cilës, ajo do të kishte fituar titullin "fizikante", por edhe sepse ajo nuk ishte diplomuar as pranë UPT-së dhe as pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Tiranë.

Në nenin 7, pika 1, të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi parashikohet: "Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim".

Nga analiza e sipërpërmendur, gjykojmë se kriteri i përcaktuar në pikën 1 të njoftimit të Rektoratit të UPT-së, për shpalljen vakant të dy pozicioneve për staf akademik pranë Fakultetit të Inxhinierisë Fizike dhe Matematike, është një kriter diskriminues për Znj. [REDAKTUAR] dhe për të gjithë ata kandidatë, të cilët kanë përfunduar studimet e larta dhe zotërojnë një diplomë të nivelit të dytë të integruar (sistemi 5 vjeçar) pranë Universiteteve të rretheve, në Fakultetin e Fizikës."

Me kalimin e afatit të përcaktuar në vendimin Nr. 6, datë 20.01.2015, pala e paditur, KMD, ka verifikuar nëse rekomandimet e dhëna prej tij janë plotësuar nga pala paditëse Universiteti Politeknik i Tiranës.

Nga verifikimi i kryer ka rezultuar se rekomandimet e dhëna nga pala e paditur nuk janë plotësuar. Si rrjedhojë KMD-ja me vendimin Nr. 103, datë 17.06.2015, në bazë të neneve 32, pika 1, germa ç), nenit 33, pikat 10, 11, 12 dhe 13/b të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", ka vendosur:

"Rektori i Universitetit Politeknik të Tiranës të gjobitet në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

...
Zbatimi i Vendimit Nr. 6, datë 20.01.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, brenda shtatë ditëve nga marrja dijani për sanksionet, sjell shfuqizimin e tyre.

Rektori i Universitetit Politeknik të Tiranës duhet të njoftojë Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në përputhje me sa parashikohet në pikën 3 të këtij vendimi."

KMD, në marrjen e vendimit të mësipërm, ka arsyetuar se:

"Në vendimin e sipërpërmendur (Nr. 6, datë 20.01.2015), palët bëhen me dije lidhur me faktin, se brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Rektori i UPT-së duhet të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit m. 10221, datë 04.02. 2011, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", palët gjithashtu njoftohen se moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.

Për sa më sipër, Rektori i UPT-së ka marrë dijani për vendimin Nr. 25, datë 20.03.2015, e Komisionerit, por edhe pse ka kaluar afati ligjor, nuk e ka njoftuar zyrtarisht KMD-në, mbi masat e marra për zbatimin e këtij vendimi. Pranë KMD-së është dërguar shkresa m.144/1, datë 25.02.2015, e Rektorit të UPT-së, ku kërkohet rishikimi i vendimit m. 6, datë 20.01.2015, por asnjëherë Komisioneri nuk është njoftuar mbi masat e marra në zbatim të këtij vendimi. Nëpërmjet shkresës Nr. 273, datë 19.03.2015, Rektori i UPT-së është sqaruar mbi faktin se kundërshtimet e tij mbi Vendimin Nr. 6, datë 25.02.2015, mund të paraqiten për shqyrtim pranë gjykatës kompetente, pasi Vendimet e Komisionerit ankimohen vetëm në rrugë gjyqësore.

Në këto kushte, Komisioneri konstaton se Rektori i UPT-së nuk ka zbatuar Vendimin Nr. 6, datë 20.01.2015, e Komisionerit dhe është në shkelje të pikës 11, të nenit 33, të ligjit Nr. 10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", ku parashikohet: "Nëse komisioneri urdhëron rregullim e ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni ".

Paditësi, UPT, gjatë gjykimit në shkallë të parë, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se:

Pala e paditur ka vepruar në tejkalim të ligjit dhe të kompetencave të saj. Znj. Gavoçi ka pranuar kushtet e konkurrimit të caktuar nga pala e paditur, për të cilat ajo nuk ka kontestuar. Në asnjë rast nuk është paragjykuar diploma e studimit apo cilësia e saj por niveli i studimit dhe fusha që ajo mbulon. Vendimi nr 103/2015 ka dalë në bazë dhe për zbatimin e vendimit në 6/2015 i cili për vlerësimin e paditësit, është nul ku dhe për rrjedhojë bënë nul edhe vendimin nr 103/2015. Vendimmarrja e palës së paditur nuk i përgjigjet realitet ligjor dhe interpretimit të tij.

Pala e paditur, KMD, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

Vendimmarrja e KMD-së është e mbështetur tërësisht në gjendjen e faktit dhe në interpretim të ligjit si rrjedhojë nuk ka vend për cenimin e saj. Në mënyrë të veçantë nuk ka pavlefshmëri absolute të akteve, pasi ato janë nxjerrë nga një organi i njohur dhe i identifikuar nga ligji dhe në respektim të plotë të kompetencave procedurës dhe formës.

Në përfundimit të gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë (në vijim referuar si "gjykata e shkallës së parë"), ka marrë vendimin përfundimtar nr. 4453 (80-2015-2747), datë 15.09.2015, me të cilin ka disponuar për rrëzimin e padisë.

Në thelb, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar, se aktet administrative të kundërshtuara nga pala paditëse, UPT, nuk janë absolutisht të pavlefshme, pasi janë nxjerrë nga një organ i identifikuar (KMD), brenda kompetencave të njohur me ligj, në formën dhe sipas procedurës së parashikuar në ligj. Pretendimet e tjera të paditësit, gjykata e shkallës së parë i ka kualifikuar si raste të pavlefshmërisë relative të akteve administrative dhe, si të tilla, nuk i ka marrë në shqyrtim.

Vendimi përfundimtar i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar nga pala paditëse, UPT, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë, sipas objektit të saj, për shkaqet që u pasqyruan në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

II. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:

A. Në lidhje me vendimin Nr. 103, datë 17.06.2015, të KMD-së:

Në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së ankimit, Gjykata Administrative e Apelit konstaton se, ankimi në pjesën që kundërshton dënimin administrativ me gjobë në masën 60,000 lekë, në bazë të vendimit Nr. 103, datë 17.06.2015, të KMD-së, nuk është paraqitur konform kërkesave ligjore të parashikuara në nenet 44, 45 e 46 të ligjit Nr. 49/2012 dhe për këtë arsye duhet vendosur mospranimi i tij për shqyrtim në këtë pjesë, për këto arsye:

Në nenin 45, të ligjit Nr. 49/2012, përcaktohet se:

“Nuk lejohet ankimi ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt:

a) kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

b) kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

c) kundërshtimin e aktit administrativ që ka refuzuar dhënien e detyrimit në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

ç) mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi”.

Siç rezulton nga përmbajtja e kësaj dispozite, ligji nuk lejon ankimi ndaj vendimeve të cilat kanë zgjidhur mosmarrëveshje administrative në lidhje me akte administrative që përmbajnë vlera më të ulëta se sa 20 fishi i pagës minimale. Ky kolegji konstaton se një nga kushtet e pranueshmërisë së ankimit është edhe vlera e detyrimit në të holla që përmban akti i kundërshtuar.

Paga minimale në shkallë vendi rezulton të jetë përcaktuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 573, datë 03.07.2013 *“Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”*. Në pikën 1 të këtij vendimi është përcaktuar se: *“Paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person juridik a fizik, vendas a i huaj, të jetë 22.000 (njëzet e dy mijë) leke.”*.

Duke llogaritur njëzetfishin e kësaj page, përcaktohet vlera 440,000 (katërqind e dyzet mijë) lekë. Kjo shumë përbën kufirin minimal të detyrimit në të holla që duhet të përmbajë akti administrativ, objekt kundërshtimi në gjykatën administrative, që të legjitimohen palët ndërgjyqëse në paraqitjen e ankimit kundër vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Në rastin konkret, objekt kundërshtimi në gjykatë është edhe masa administrative e vendosur nga KMD-ja ndaj palës paditëse, UPT, në bazë të nenit 33(11) të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*.

Në këto kushte, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se ankimi i paraqitur nga pala paditëse, UPT, në pjesën që kundërshton dënimin administrativ me gjobë në masën 60,000 lekë, nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë, për pasojë, referuar nenit 50, germa “a” të ligjit Nr. 49/2012, duhet të vendoset mospranimi i ankimit.

B. Në lidhje me vendimin nr. 6, datë 20.01.2015, të KMD-së:

Gjykata Administrative e Apelit, çmon të vërë në dukje se, në nenin 37 të ligjit nr. 49/2012 përcaktohet se: *“Gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ”*.

Gjykata e Apelit, *in primis*, vlerëson se, vendimi i KMD-së, nr. 6, datë 20.01.2015, është akt administrativ individual, në kuptimin që i japin atij neni 105¹ i Kodit të Procedurave Administrative (miratuar me ligjin Nr. 8485, datë 12.05.1999 - në fuqi në kohën e daljes së aktit administrativ) dhe neni 2/2 i ligjit Nr. 49/2012². Ky vendim ka dalë nga një organ i administratës, në kuptim të nenit 3 të Kodit të Procedurave Administrative (në vijim: "KPA"), ku përcaktohet se organe të administratës publike janë, ndër të tjera (*inter alia*), edhe institucionet e pavarura, në rastin kur ndërmarrin sanksione administrative, për shkeljet e konstatuara në ligjin përkatës, që i ngarkon ato me funksione inspektuese dhe ndëshkuese (siç është edhe KMD-ja).

Në të drejtën administrative, fjala akt, nënkupton një veprim i cili ka për qëllim të prodhojë efekte juridike, të krijojë, ndryshojë apo shuajë një marrëdhënie juridike të caktuar. Kjo do të thotë që ai shpreh një vullnet të qartë të subjektit që e krijon dhe që, në kontekstin e rastit për shqyrtim, janë organet shtetërore që ushtrojnë veprimtari administrative. Akti administrativ është konceptuar si shfaqje e një vullneti pushteti nga organet që ushtrojnë veprimtari administrative, në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe me ligjet, me qëllim krijimin, ndryshimin ose shuarjen e pasojave të caktuara juridike, i zbatuar nëpërmjet vullnetit të lirë të subjekteve të cilëve u drejtohet ose me anë të fuqisë shtrënguese të shtetit.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues Nr. 2, datë 10.03.2014, sjellin në vëmendje disa nga kriteret që gjykatat duhet të mbajnë parasysh për të përcaktuar nëse një mosmarrëveshje është apo jo e natyrës administrative:

- a) njëra nga palët në mosmarrëveshje ka natyrën e organit të administratës publike, në kuptim të rregullimit ligjor në fuqi dhe, në kuadër të kryerjes së veprimtarisë të njohur nga ligji, ushtron pushtetin e tij diskrecional ndaj palës tjetër;
- b) veprimtaria e organit të administratës publike bazohet në një ligj të posaçëm të së drejtës publike dhe vetë marrëdhënia juridike që krijohet në mes palëve buron nga një ligj i të drejtës publike;
- c) kjo veprimtari e organit të administratës publike, që konkretizohet me nxjerrjen e aktit, duhet të veprojë në drejtim dhe të ketë si bazë interesin publik.

Gjykata e Apelit, çmon të vërë në dukje se, në objektin e padisë nga paditësi UPT pretendohet pavlefshmëria absolute e vendimit Nr. 6, datë 20.01.2005 të KMD-së. Ashtu siç drejt ka arsyetuar gjykata e shkallës së parë, në rastin *de quo*, paditësi UPT e ka kufizuar hetimin gjyqësor të çështjes rreth përcaktimit të rasteve të pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ.

Duke qenë përpara kërkimit për pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, në rastin në gjykim (*de quo*) çështja eventuale e respektimit të afatit të kundërshtimit të aktit administrativ në gjykatë, nuk paraqet rëndësi, në vështrim edhe të nenit 18, pika 8, të ligjit Nr. 49/2012, sipas të cilit pavlefshmëria absolute e akteve administrative, mund të pretendohet në çdo kohë.

Gjykata e Lartë, në raste të ngjashme ka një jurisprudencë të konsoliduar, ku ka tërhequr vëmendjen e gjykatave më të ulëta, për të fokusuar hetimin gjyqësor vetëm në verifikimin e

¹ Ky nen ka këtë përmbajtje: "Për qëllimet e këtij ligji, do të konsiderohen akte administrative të gjitha vendimet e organeve të administratës publike, të cilat krijojnë pasoja juridike në raste individuale."

² Kjo dispozitë përcakton: "Akt administrativ individual" është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijojnë, ndryshojnë ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete."

rasteve të pavlefshmërisë absolute të akteve administrative, kur padia ka për objekt një kërkim të tillë. Ajo ka arsyetuar se:

"[...] Me të vërtetë, kushdo që ka interes, mund të kërkojë në gjykatë pavlefshmëri në absolute të një akti administrativ, pa qenë e domosdoshme të ndjekë paraprakisht rrugë administrative ankimi. Por, në këtë rast, gjykata e shqyrtton çështjen vetëm për të vërtetuar ose jo ekzistencën e njërit prej shkaqeve shprehimisht të parashikuara nga ligji për nulitetin e aktit administrativ. Nëse në përfundim të shqyrtimit gjyqësor nuk rezulton i provuar nuliteti i aktit administrativ dhe ligji i posaçëm parashikon rrugë administrative të detyrueshme ankimimi, atëherë gjykata nuk vendos rrëzimin e padisë, por e nxjerr çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, madje edhe nëse nga rrethanat e çështjes do të rezultonte se mund të çenohej ai akt administrativ për shkaqe të lidhura me pavlefshmërinë relative të aktit. ... Nuliteti i aktit administrativ është një lloj kërrimi e një lloj padie e dallueshme nga kërkimet e paditë e tjera për kundërshtimin e aktit administrativ. Prandaj edhe nevojitet që paditësi ta ketë kërkuar nulitetin e aktit administrativ në padi. (...)"³

Në analizë të pretendimeve të parashtruara në ankim nga paditësi, të rrethanave të faktit e të ligjit, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se përfundimi i arritur nga gjykata e shkallës së parë, për rrëzimin e padisë në pjesën që kërkohet pavlefshmëria e aktit administrativ, vendimit nr. 6, datë 20.01.2015, e KMD-së, është i drejtë dhe vendimi duhet të lihet në fuqi.

Lidhur me pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ objekt gjykimi, në analizë të rrethanave faktike dhe ligjore, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, vendimi nr. 6, datë 20.01.2015, i KMD-së, nuk është nxjerrë në kushtet e nulitetit të tij.

Ky kolegji i Gjykatës së Apelit, çmon se, ndryshe nga sa ka pretenduar pala paditëse, akti administrativ, objekt i shqyrtimit gjyqësor, është i vlefshëm, pasi është marrë nga organi kompetent (KMD) në zbatim të kompetencave të tij ligjore dhe ai është produkt i një procedurë administrative të rregullt, të saktë dhe në përputhje të plotë me aktet normative relevante.

Ky kolegji vë në dukje se një akt absolutisht i pavlefshëm konsiderohet në kundërshtim flagrant me ligjin, shkelje e cila vlerësohet në një masë të tillë sa e bën aktin inekzistent nga pikëpamja juridike. Meqenëse një akt i tillë vlerësohet se nuk ka sjellë asnjëherë pasoja juridike (neni 117, pika 1 e KPA-së), situatat që përbëjnë pavlefshmëri absolute janë përcaktuar nga ligji në një listë shteruese në nenin 116 të KPA-së, i cili lexon:

"Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, në rastet e mëposhtme:

- a) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar;*
- b) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore;*
- c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji."*

Në kuptim të nenit 116 të KPA-së, që një akt administrativ të nxjerrë në kundërshtim flagrant me ligjin duhet të plotësojë njërin nga kushtet e mëposhtme:

- a) akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar:*

³ Shih ndërmjet shumë të tjerëve, vendimet e Gjykatës së Lartë, nr. 00-2013-1160 (110), datë 12.02.2013 dhe nr. 00-2013-2341 (542), datë 03.10.2013.

Që një organ të konsiderohet i njohur nga ligji, ai duhet të jetë pajisur me tagër pushteti, të jetë kompetent për veprimtarinë konkrete administrative që do të kryejë, si dhe të ketë strukturën përkatëse organizativo-administrative. Akti objekt padie, është nxjerrë nga pala e paditur, KMD-ja, i cili është institucion i pavarur, me adresë dhe vendndodhje të saktë dhe të përcaktuar në bazë të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi, si organ i identifikuar që operon në fushën e mbrojtjes kundër diskriminimit.

b) akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore:

Për të ushtruar pushtetin nëpërmjet shfaqjes së vullnetit juridik përkatës, është e nevojshme jo vetëm qenia si një organ i identifikuar i administratës publike, por dhe pajisja nga ligji me tagrat e nxjerrjes së aktit administrativ. Pala e paditur është organ administrativ i përcaktuar me ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi, i cili ka sanksionuar kompetencat në fushën që mbulon, me qëllim ushtrimin e të drejtave dhe detyrave brenda juridiksionit përkatës. Pala e paditur, KMD, siç do të argumentojmë më poshtë (*infra*) i ka ushtruar kompetenca brenda kufijve të ligjit, pasi në të kundërt, ky veprim do të përbënte cenim të parimit të ligjshmërisë.

c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji:

Respektimi i formës dhe procedurës për nxjerrjen e aktit administrativ përbën një nga elementët më të rëndësishëm që përcakton vlefshmërinë e tij. Shkelja e formës dhe e procedurës mund të paraqitet me të gjitha mënyrat, por e rëndësishme është të kuptohet se jo të gjitha shkeljet që lidhen me formën dhe procedurën mund të shpien detyrimisht në pavlefshmërinë e aktit. Mosrespektimi i këtyre elementëve duhet të jetë i atij karakteri dhe të asaj rëndësie që të kenë ndikuar drejtpërsëdrejti në nxjerrjen e aktit. Në gjykim është provuar se, pala e paditur nuk e ka shkelur procedurën e nxjerrjes së aktit dhe ky i fundit ka respektuar kërkesat për formën e tij.

Ky kolegji vëren se, ashtu siç saktësisht ka përcaktuar gjykata e shkallës së parë, në rastin në gjykim nuk kemi të bëjmë me kapërcim të kompetencave të Komisionerit, pasi ai, pasi ka konstatuar diskriminim të drejtpërdrejtë të të paditurës, [REDACTED] për shkak të gjendjes arsimore dhe diskriminim të tërthortë të kandidatëve që janë diplomuar pranë Universiteteve të Rretheve, në Fakultetin e Fizikës dhe zotërojnë një diplomë të nivelit të dytë të integruar, për shkak të gjendjes arsimore, nga ana e palës paditëse, Universiteti Politeknik i Tiranës, në zbatim të kompetencave të tij, të njohura me ligjin Nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", ka rekomanduar edhe marrjen e masave përkatëse.

Ndryshe nga sa ka ngritur në ankim pala paditëse, KMD-ja ka vepruar brenda sferës së kompetencave të saj, duke mos ushtruar apo marrë kompetenca të ndonjë organi tjetër. Në lidhje me bazueshmërinë faktike dhe atë ligjore të këtij akti administrativ, ato i referohen pavlefshmërisë relative të aktit administrativ (neni 118 i K.Pr.Administrative) dhe jo asaj absolute, ndaj nuk mund të merren në shqyrtim nga ky kolegji gjykues, për sa kohë nuk është kërkuar kjo lloj pavlefshmërie.

Në këto kushte, duke mos u vërejtur asnjë ves i pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 6, datë 20.01.2015, të KMD-së, konkludohet se, ky kërkimi i paditësit, UPT, në zbatim korrekt të ligjit është rrëzuar nga gjykata e shkallës së parë, ndaj në këtë pjesë ky vendimi i saj duhet konfirmuar nga Gjykata e Apelit Administrativ. Rrjedhimisht, shkaqet e invokuara në ankim nga paditësi nuk duhen pranuar, si të pabazuara në ligj.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Administrative e Apelit, mbështetur në nenin 50, shkronjat "a" e "b" të ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit Nr. 4453 (80-2015-2747), datë 15.09.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, për sa i përket kërimit për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit Nr. 6, datë 20.01.2015, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Mospranimin e ankimit të palës paditëse, Universiteti Politeknik i Tiranës, kundër vendimit Nr. 4453 (80-2015-2747), datë 15.09.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, për sa i përket kërimit për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit Nr. 103, datë 17.06.2015, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
3. Kundër vendimit mund të ushtrohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 ditëve, duke filluar nga e nesërmja e njoftimit të tij.

- *U shpall në Tiranë, sot në datë 18.12.2018.*

ANËTAR
BARI SHYTI
(d.v.)

ANËTARE
ALKELINA GAZIDEDJA
(d.v.)

KRYESUES
AMARILDO LAÇI
(d.v.)

E njëjtë me origjinalin

Kancelari
Leonard Stealy
Amari

100